

SHERBËTORË I HYJIT

Fabrizio Boero

(1974 - 1993)

“Zambaku” nga
Canale d’Alba

SHOQATA MIQTË E FABRIZIO BOERO
(nën përkujdesjen e postullatiçes Lia Lafronte)

Nëse doni të komunikoni lajmet për hiret e marra
me ndërmjetësimin e Shërbëtorit të Hyjit, shkruani:

postulazionefabrizio@libero.it

*Nëse dëshironi të bëni një ofertë për përhapjen e figurës së Fabrizios
e për çështjen e tij, iu komunikohet IBAN-i i Shoqatës që është kri-
juar në emër të tij, jofitimprurëse:*

Shoqata e Miqve të Fabrizio Boero

Dega e Banca d'Alba Credito Cooperativo SC Canale

IBAN IT38J0853046060000000262978

BIC ICRAITRREQO

*Në besnikërinë
e përditshme
të Ungjillit dhe në
përkushtimin ndaj
Virgjërës Mari
kultivoj pastërtinë e zemrës
si një rrugë e premtuar
nga Lumturitë*

Fabrizio Boero lindi në Torino më 12 qershor 1974 nga Gianfranco dhe Gabriella Tiglio. Vetëm pak ditë pas lindjes, prindërit e tij kthehen me të në Canale (CN), ku kishin vendbanimin e tyre. Gjyshja Delfina e pret me motren e tij Danielën, e cila ishte pesë vite më e madhe.

Më 28 korrik të të njëjtit vit, Fabrizio u pagëzua në Kishën Famullitare të Shen Vittore, në të cilën ka marrë pjesë në çdo aktivitet gjatë gjithë jetës së tij. Fabrizio ishte një fëmijë që ngjallte menjëherë habi në shtëpi dhe mes priftërinjve që e njihnin, sepse, në moshën shtatëvjeçare, luste çdo ditë me gëzim rruzaren e shenjtë.

Nëna e tij, kur shkante për t'i thënë natën e mirë, e gjente gjithmonë me rruzare në duar. Me siguri, tek ai kanë ndikuar; besimi i familjes, mësimet e mësueses që e ka shoqëruar në Kungimin e Parë dhe mbi të gjitha shembulli i gjyshes së tij Delfina, pranë së cilës luste shpesh dhjetëshet e dashura për Zojën. Të gjithë ata që ishin afër tij hetonin tek ai, një nxitje personale të fortë dhe të pazakontë devotshmërie.

Kur bëri kungimin e parë, në moshën tetë vjeç, ai u dallua si fëmija i vetëm që, pasi mori Jezusin, nuk vrapoj për të



Ditëlindja e tretë e Fabrizios

festuar me shokët e klasës dhe të afërmit, por qëndroj i gjunjëzuar për një kohë të gjatë në stolin e tij i zhytur në kuptimin e thellë të misterit Eukaristik dhe të zotërimit të tij kaq intim, Hostja e bërë Trupi i Jezusit, donte ta luste me më zjarr dashurie.

Si fëmijë, ishte shumë i lezetshëm, në një ese të shkollës fillore shoku i tij më i ngushtë e përshkroi atë "sy gjelbër si sytë e maces".

Ëmbëlsia e tij, tiparet delikate të fytyrës së tij sigurisht që e bënë atë imazhin e një engjëlli të vogël. Kështu e përshkruajnë shumë njerëz që e kanë parë duke shërbyer në altar. Pasi u bë ministrant: të gjithë vërenin, se imazhi engjëllorë i përkiste më shumë ëmbëlsisë së qenies dhe lëvizjes mes gjërave të shenjta, sesa delikatesës së tipareve të tij.

Fabrizio ishte i magjepsur prej botës shpirtërore dhe dukej se gjithçka tjetër në jetën e tij, e cila ishte e mbushur me shumë gjëra si ato të një fëmije normal, e më pas të një djaloshi, dolën në plan të dytë.



Fabrizio ditën e Kungimit të parë

Atij i pëlqente të shihte kullën e kambanës së kishës së Shën Vittore dhe notat e kambanave nga oborri i shtëpisë së tij ishin për të një kujtim i butë i liturgjive që thërrisnin. Edhe si fëmijë i pëlqente të shkonte i vetëm në kishë për të përshëndetur Jezusin dhe Zojën, ashtu siç e donte gjithmonë adhurimin e vetmuar të Jezusit në Tabernakull dhe

*“Për mua një ditë në shtëpinë
tënde është më mirë
se me mijëra diku tjetër”*

(Ps 83,11)

dialogun e heshtur me Qiellin. Miqtë e tij vërenin shpesh biçikletën e tij të mbështetur në murin e kapelës së kishës së

famullisë dhe, po të hidhnin një sy brenda, e gjenin të zhytur në lutje.

Murgeshat Sakramentine të Canale e panë atë shpesh në kishën e tyre në adhurim, edhe kur ajo ishte e heshtur dhe pa besimtarë.

Rreth njëmbëdhjetë vjeç Fabrizio u emërua përgjegjës për djemtë ministrantë të famullisë Canale nga zëvendës-famullitari i kohës, Don Eligio Mantovani, i cili kujdesej për të rinjtë.



Kungimi i Fabrizioos në shugurimin meshtarak të Don Eligio Mantovani

Fabrizio nuk ishte më i madhi nga djemtë, por ishte ai që ndërvepronte me objektet e shenjta të altarit, me më shumë respekt e përkushtim dhe më i përfshirë në shërbimin që do të kryhej përkrah priftit. Sigurisht, ai ishte gjithmonë i disponueshëm, i saktë dhe i kujdesshëm për të trajtuar me delikatesë dhe autoritet dhjetëra fëmijë dhe të rinj të tjerë që i ishin besuar në atë kohë. Të gjithë miqtë që kishin veshur tunikën e ministrantit si ai, e kujtojnë si një udhërrëfyes të sigurt dhe autoritar, pavarësisht përulesisë së madhe të tij. I riu Fabrizio ishte gjithmonë i dashur dhe i disponueshëm në shtëpi, i sjellshëm dhe kurrë kapriçioz. Edhe pse dukej shumë serioz, i vetëdijshëm dhe i pjekur, ai ishte një djalë normal për sa i përket argëtimit, lojërave, dhe dëshirave: i pëlqente të dëgjonte muzikë, i pëlqente të ngaste biçikletën dhe të luante futboll e volejball. Nën drejtimin e babait të tij Frankos, ai zotëroi gdhendjen e kungujve të tharë për t'i dekoruar dhe punimin e drurit për të bërë objekte të lezetshme. Megjithatë, më shumë se çdo gjë, atij i pëlqente të vizatonte: kishte një talent të vërtetë për të riprodhuar makina garash, por preferonte tema të shenjta. Në vizatimet, të cilat i ka ruajtur nëna Gabriella, perceptohet një delikatesë mallëngjyese. Në një nga vizatimet, paraqitet Zoja e famshme nga Roberto Ferruzzi, e quajtur gjithashtu 'Zoja e Pushimit' (ose 'Zingarella/gabelja'); subjekti origjinal, në realitet, nuk kishte lindur si një portret i shenjtë, por në fakt u bë i tillë. Në kokën e vogël të fëmijës të vizatuar nga Fabrizio ka plot kaçurrela shumë të ngjashëm me të tija kur ishte i vogël dhe thuhet se duket sikur kishte riprodhuar vetveten në krahët e Zojës, në një braktisje totale ndaj saj. Pavarësisht se ishte shumë i turpshëm, që në shkollën

fillore ka pasur miq, ndaj të cilëve ka qenë gjithmonë i gëzuar, i dashur dhe i dobishëm. Megjithëse, të gjithë miqtë e tij e donin dhe e respektonin për thjeshtësinë, dashamirësinë dhe disponueshmërinë e tij, teksa ai u rrit, pati një ndryshim të rëndësishëm tek ai, një ndikim të fortë në marrëdhëniet e tij me disa nga shokët e fëmijërisë. Fabrizio, në fakt, gjithnjë e më shumë ndjente brenda vetes thirrjen e besimit, përkushtimit dhe mbi të gjitha respektimin e vlerave të propozuara nga Lëvizja RZM (Rinia e Zjarrtë Mariane), sipas udhëzimeve të Don Eligios.

Lëvizja rinore RZM-ne e frymëzimit Eukaristik, Marian, kishtar dhe ungjillizues ka një ëndërr, të ndërtojë Qytetërimin e Dashurisë dhe të përgatisë Pranverën e Kishës. Ai propozon rizbulimin e Rrëfimit si një përvojë gëzimi dhe Eukaristinë si një përvojë të Qiellit dhe ringjalljes.

*"Më ke thirrur,
Ja ku jam!"*

(1 Sam 3,8)

Ai shpallte Ungjillin mbi të gjitha në "Qenakujt" (qenakull quhej çdo takim lutjeje ku bashkoheshin për të dëgjuar Fjalën e Zotit e lutur rruzaren) dhe propozonte Rruzaren dhe dashurinë për pastërtinë, në imitim të Virgjëres së Shenjtë, duke formuar kështu apostuj të rinj të zjarrtë, dëshmitarë të gëzimit. Fabrizio ishte ai që në Canale, qe i pari që me gëzim pranoi ti përgjigjej propozimit të Don Eligio-s, duke bashkëpunuar në këtë projekt me entuziazëm të gjallë. Në këtë Lëvizje Fabrizio gjeti realitetin e asaj që ndjente natyrshëm brënda vetes, duke arritur të vëndosë në të, të gjitha burimet e tij shpirtërore.

Përkushtimi i tij ndaj atyre vlerave të përquafuara plotësisht nuk u pa gjithmonë mirë nga disa miq dhe fëmijë të tjerë. U kundërshtuan si pjesëtarë të gëzueshëm të RZM-ne, të cilët asokohe ende nuk ishin mirëpritur zyrtarisht në famulli, qoftë ai, qoftë personi që e kishte propozuar atë levizje fetare vërtetë të jetuar, domethënë Don Eligion.

*“Para se të formoja
në kraharorin amnorë
të njoha”*

(Jer 1,5)

Fabrizio, bashkëpunëtori i tij më entuziast, më i madh dhe i zellshëm, e pagoi çmimin më shumë se kushdo tjetër, duke përfunduar në tallje shumë të rënda. Gjithashtu, shpesh herë

talljet dhe përçmimet i duronte në heshtje, pa u zemëruar apo ankuar, por me kokën lart: absolutisht duke mos ndryshuar



Fabrizio në oborr në mes të misërit

mënyrën e të vepruarit dhe duke vazhduar të dëshmojë për besimin dhe antarsimin e tij në RZM-në, me të cilin e lidhte një bashkim i fortë vlerash. Mund të thuhet se ai ishte një “Sabra” i vërtetë i RZM, sipas përkufizimit të Shërbëtorit të Zotit Don Carlo De Ambrogio, themeluesit, në këtë tokë, të RZM-ne: “Fjala 'sabra' është emri i një bime nga Shkretëtira e Negev, rezistuese ndaj të gjitha kushteve të motit dhe, rrjedhimisht, është emri i një rinie të re, të “rrahur”



Fabrizio në dhomën e ndenjes të shtëpisë

nga të gjitha sakrificat, e vendosur për të krijuar Qytetërimin e Dashurisë.

Fjala SABRA mund të gërmëzohet kështu: Gjithmonë Adhuroni, Bekoni, Falenderoni, Shpallni : ky është misioni i të rinjve të RZM-ne, të cilët, të mbushur me Shpirtin e Shenjtë, janë të përkushtuar për ungjillizim. Sabra: emër i ri për një mision të ri”. Fabrizio u përgjigj talljeve të tjerëve duke sjellë në mënyrë ungjillore faqen tjetër, duke mos ua mohuar kurrë dashurinë miqëve të tij, duke mos i vënë në dukje asnjëherë negativisht për atë që pësonte personalisht.

Ai sigurisht nuk pranoi t'i nënshtrohej sjelljeve që nuk i kishin

hije përshpirtërisë së tij, por njëkohësisht nuk u mbrojt nga ofendimet apo edhe akuzat e rreme që mund t'i bëheshin. Kjo për të do të thoshte të jepte dëshmi për Ungjillin duke përqaftuar kryqin e Jezusit çdo ditë. Ai kishte një prirje të madhe për falje dhe mrekullohej me forcën e tij për të çuar përpara, në heshtje, ditë pas dite, atë martirizim të vogël që ai nuk e kundërshtoi por, të cilën e përballoi me buzëqeshje dhe dashuri të përtërirë. Ai shpresonte se dëshmia e tij e heshtur një ditë do të jepte fryt tek të gjithë ata që nuk e donin besimin e tij. Rreth moshës pesëmbëdhjetë vjeç, famullitari i Canale, Don Angelo Conterno, i bindur nga përkushtimi i tij, i propozoi që të hynte në seminar për t'u bërë prift. Fabrizio ishte ende i pasigurt, natyrisht, jo për fenë dhe besimin, por për gjëndjen e jetës në të cilën do t'i praktikojë ato. Ai ishte ende i ri dhe po vazhdonte studimet për kontabilitet. Ai ende dëshironte të reflektojë, sepse për Zotin, thotë ai, gjërat duhet të bëhen gjithmonë mirë.

Programi shpirtëror i Fabrizioos që kur ishte fëmij, ishte, të përpiqej të arrinte pastërtinë e Virgjërës Mari duke ndjekur shembullin e Shën Dominik Savios dhe Shën Maria Goretit, sepse "të pastërit në zemër

"Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin Hyjin."

(Mt 5,8)

do ta shohin Hyjin", siç u premtua në Lumturitë.

Ai i shkroi një lutje shumë të ëmbël Zojës, të cilën e quajti me ëmbëlsi Nënë, si të gjithë të rinjtë e lëvizjes

RZM-ne, që të ndihmohej të jetonte në pastërti si e reja Goretit Martire e Shenjtë. Ai ishte një djalë që shkante

kundër rrjedhës për kohën, por ishte i vendosur dhe i gëzuar në bindjen e tij, edhe pse kjo është gjithnjë shkak sakrificash dhe vetmohimesh për të. Ndjente simpati për ca vajza, por kërkimi i vazhdueshëm i pastërtisë është më i fortë se kurrë dhe nuk shkon përtej miqësisë me asnjë të re.

Fabrizio, siç ka shkruar edhe vetë, dëshiron të

dëshmojë në jetë se “Zoti është Dashuri”. Ai është i bindur se pranimi i sakrificës e bën njeriun të rritet shpirtërisht dhe ofron të gjitha vuajtjet e tij në mënyrë që të bëhet një llambë që digjet nga dashuria për Dashurinë.

Sakrifica, pastërtia, dëshmia janë ato nga të cilat është i prirë Fabrizioo teksa dëshiron të ngjisë shkallët e mundimshme që të çojnë në shenjtëri. Miqtë e tij e shihnin si një “marsian shpirtëror”, si dikush që është në një nivel shumë më të lartë të besimit si edhe më i devotshmi i bashkëmoshatarëve të tij dhe madje edhe të miqve e tij që i përkisnin Lëvizjes RZM-ne.

Ai dëshiron që RZM-ne të njihej si shoqatë edhe në famullinë e Canale d'Alba. Ai mori pjesë në misionet e para në qytetet e afërta, duke rigjallëruar “Qenaku”, dhe ishte i pari me Don Eligio dhe një mik tjetër më të vjetër që mori



Fabrizio ministrant (në të djathtë) me mikun Aleksandro Borlengo

pjesë në një udhëtim në Romë (i cili u pasua nga një tjetër) për të bashkëndarë më së miri përshpirtërinë që propozonte Lëvizja. Ai kthehet në Canale nga këto udhëtime gjithnjë e më i entuziastë, i sigurt se RZM-ne do të arrijë, pavarësisht vështirësive të asaj periudhe, të vendoset edhe në vendin e tij.

Me kalimin e moshës ai bëhet gjithnjë e më i njohur si një djalë plot virtyte. Në heshtje, ai ja ofron Zotit vuajtjet e tij, sepse e dinte se vuajtja e ofruar ka vlerë të madhe në sytë e Tij. Një mik, gjatë një "Qenakulli" të RZM-ne e dëgjoi atë duke kërkuar në lutje, që të jetë i ndihmuar për të mbajtur Kryqin: një Kryq të cilin ai e mbante pa akuzuar askënd si shkak të tij.

Ai jep provimet për të marrë lejen e drejtimit, i kalon shkëlqyeshëm, por nuk arrin në kohë ta ketë fizikisht në dorë patentën, pasi do t'i mbërrijë në shtëpinë e tij kur të jetë në shtratin e spitalit, në gjëndje kome.



Fabrizio i vogël në ekskavator për punimet në oborr



Fabrizio në këmbë në mal, me qiellin blu në sfond

Pak kohë përpara kishte filluar vitin e pestë të shkollës së mesme dhe e paparashikueshmja u bë realitet: të shtunën, më 28 nëntor 1992, duke përdorur për herë të parë në mbrëmje makinën e babait të tij Gianfranco, për shkak të motit të keq, rrugës rrëshqitëse dhe papërvojës së tij në timon, Fabrizio përplasat për një pemë së bashku me disa shokë teksa po bënë një shëtitje në qytetin e afërt të Albës.

Të gjithë djem të mirë, të cilët kishin marrë pjesë në festën e ditëlindjes së një shoqeje, në një sallë të famullisë, ku nuk pihej alkool, sidoqoftë Fabrizio nuk e pinte alkool.

Vetëm për të aksidenti pati pasoja tragjike: fraktura të shumta, duke përfshirë një në nofull, një në këmbë dhe një në krah, dhe një dëmtim të rëndë në kokë.

Miqtë e tjerë po ia dilnin të shëroheshin mjaft mirë.

Operationet kirurgjikale të cilave u nënshtrohet Fabrizio nuk arrinin për ta ndihmuar që ti rikthehet vetëdija. Ai qëndron në gjendje kome, të paktën në dukje, deri në vdekje.

Pasditen e asaj të shtune fatale, ai kishte marrë pjesë në Meshën e Shenjtë dhe kishte marrë Kungimin. Ai i kishte thënë nënës së tij se nuk e dinte nëse do të mund të shkonte të nesërmen.

Nuk kishte ndodhur kurrë që ai të thoshte një gjë të tillë: duke mos pasur asnjë lloj angazhimi, ai preferonte meshën e së dielës më shumë sesa meshën e shenjtë festive të së shtunës, sepse ishte më e gëzueshme, pasi gjallërohej nga këngët e fëmijëve. Prandaj, Fabrizio bën Kungimin e Shenjtë të fundit të jetës së tij dhe bie në gjumë në bardhësinë e shpirtit të tij

“Kush ushqehet me trupin tim dhe pi gjakun tim ka jetën e pasosur”

(Gjoni 6,54)

ka vetëdije por shumë dëshmitarë, nga më të ndryshmit, dhe pa ditur perceptimet dhe deklaratat e të tjerëve, thonë që janë të sigurt për perceptimin e Fabrizioos për atë që ndodh rreth tij sidomos në disa momente të caktuara si, të lutjes dhe të përfshirjes emocionale.

Don Eligio shkonte për ta vizituar pothuajse çdo ditë dhe me të ndante shqetësimet dhe shpresat e “foshnjes së palindur” d.m.th të RZM-ne në Canale dhe i kërkon atij (i sigurt se do të dëgjohet) të ofrojë gjithëçka Zotit për këtë qëllim, i bindur se nëpërmjet vuajtjes së tij do të ndodhë mrekullia që të gjithë kërkuan për shërimin e tij dhe hirin e njohjes së Rinisë së Zjarrtë Mariane.

Kërkesa e parë nuk realizohet as kur tre murgesha shumë të

kundër një peme, me fytyrën e mbështetur në timonin e makinës UNO burdeaux të babait. Nga ai moment fillon kalvari i tij. Mjekët thonë që nuk

dashura për të, shkojnë në një audiencë private me Shenjtin At Papë Gjon Palin e II dhe i kërkojnë të lutet për shërimin e tij. Ai u jep një Rruzare të bardhë për nënën e djalit, Gabrielën, në mënyrë që ajo të ketë forcën për të duruar sëmundjen e djalit. Ajo rruzare, e dhuruar nga një shenjtë i madh, do të jetë në duart e Fabrizios në ditën e funeralit të tij, në mënyrë që të mund ta marrë me vete në Parajsë dhe ta lusë sa herë të dojë, tashmë i mbështjellë në përjetësinë e kohës.

Kërkesa e dytë e Don Eligio-s realizohet pas disa vitesh dhe shumë mundimeve: me 12 qershor 2011, solemniteti i Rrëshajëve, ipeshkëvi i Alba Imzot Giacomo Lanzetti, njuh zyrtarisht RZM-ne të ALBA LANGHE dhe ROERO si Shoqatë private të besimtarëve. Don Eligio ka qenë gjithmonë i bindur se vuajtja e Fabrizios, të cilën e konsideronte si mbështetëse të asaj të Krishtit, të jetë dhuruar totalisht prej tij për lindjen zyrtare të RZM-ne në Canale.

Me 12 qershor, njohja zyrtare e RZM-ne dhe dita e Ditëlindjes së Fabrizios: një rastësi e lumtur apo një provani e Zotit?

"Nëse kokrra e grurit vdes, jep shumë fryte"
(Gjoni 12,24)

"Shenjat" vijnë për të ndriçuar dhe treguar gjëra të cilat mëndja njerëzore në hutim e sipër nuk u jep rëndësinë e duhur, të cilën pothuajse nuk e vëren...

Gjatë sëmundjes së Fabrizios shumë miq kanë pasur mun-

dësinë të rimëndojnë mbi të dhe mbi shëmbullin e jetës së tij, duke i ribesuar figurës së atij djali i cili vihej në lojë për besimin dhe devotshmërinë e tij.

Në mënyrë absolutisht të papritur, kaloj një kalvar të gjatë në shtrat pothuajse totalisht i paralizuar dhe i burgos brënda vetes, heshtja e Fabrizioos, gjithmonë i gatshëm për

dëshminë e jetuar, ia doli në qëllimin e tij në të qëniti flakë e gjallë për të dëshmuar se Zoti është Dashuri, siç kishte kërkuar të jetë. Sa zemra të shëndërruara falë sëmundjes dhe jetës së tij tokësore të ndërpre-rë! Sa shumë të rinjë kanë kuptuar papjekurinë që është në bazë të veprimëve bullizuese dhe dëmin që këto akte mund



Krezmimi i Fabrizioos në kishën e Shen Vittore a Canale

të shkaktajnë. Sa shumë miq e kanë zgjedhë si model për t'u bërë më të mirë!

Sa të rinj të RZM-ne kanë gjetur forcën për të thënë po-në e tyre nga shembulli i një lajmëtari të ri të Ungjillit, i cili shpërndande buzëqeshje dhe mirësi rreth tij ndërsa thjesht dëshmonte të “jetuarit” Krishtin!

Nga data 24 shtator 1993, dita e lindjes së tij në Qiell, ai është bërë edhe më shumë një llambë ndriçuese, siç dëshironte, që ndihmon të shohësh rrugën, të gjesh lumturinë e vërtetë, thesarin e fshehur: Jezusin.


Mesazhi i Fabrizioo-s në përpjekjen e shenjtërisë duke pranuar dhe duke mbajtur Kryqin, duke dëshmuar gjithmonë dashurinë për Zotin dhe për Nënë Qiellore, duke jetuar në pastërti, duke dhënë faljen ku pranohen fyerjet dhe duke ungjillizuar me shembull, nuk ka rënje dhe nuk mund të bjerë në zbrazëti.

Ditën e 13 korrikut 2022 i është prezantuar Shkëlqesisë së Tij Imzot Brunetti kërkesa për fillimin e Çështjes së Lumturimit dhe Kanonizimit për të riun Fabrizioo; Pjesë aktive e këtij procesi është Shoqata private e besimtarëve “Miqte e Fabrizioo Boero”, e njohur kanonikisht me 4 shkurt 2022. Me pranimin zyrtar të kërkesës, Fabrizioo Boero, djali i ri nga Canale d'Alba, sipas normave kanunore është bërë SHËRBËTORË I HYJIT.

Me kohët e vendosura nga Zoti i mirë, le të shpresojmë që sa më shpejt të jetë e mundur Fabrizioo të mund të ngrihet në nderet e altarëve.

Më poshtë është pjesa e një lutjeje
të shkruar nga Fabrizio kur ishte rreth
pesëmbëdhjetë vjeç

*“O nënë qiellore,
ta besoj zemrën time,
formoje si Ti don,
mbushe me mendime, fjalë,
vepra të pastra si të tuat.
Më jep siguri se vetëm të pastërit
në zemër
mund ta shohin Hyjin ...
bëj që jeta ime të shkëlqejë si një llambë
që digjet në mënyrë që,
të gjithë ata që më afrojnë
të mund zbulojnë gjithashtu në mua
se “Hyji është dashuri”.*



Më 12 nëntor 2022 Ipeshkëvi i Alba Imzot

Marco Brunetti

ka pranuar zyrtarisht kërkesën

paraqitur për fillimin e

Hetimit Dioqezan për Çështjen e

Lumturimit dhe Kanonizimit të

FABRIZIO BOERO

lindur në Qiell më 24 shtator 1993.

U mbajt seanca e parë e Çështjes

në Katedralen e Albës më 27 janar 2023.

Tani shpresojmë se do të vazhdojë

në mënyrën më të mirë dhe që Fabrizio të

mundet së shpejti të shpallet i Nderuar